

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Tiranë, zonja Mimi Pjetër Kodheli”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**
- **Parti Politike:**

**Z.I.Celibashi:** Mirëdita! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend dite 4 çështje:

Projektvendimi që ka të bëjë me dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për Qarkun Tiranë, zonjës Mimi Kodheli;

projektvendimin mbi dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për Qarkun Durrës, Denis Deliu;

projektvendimi për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për Qarkun Fier, zonjës Mirela Pitushi;

dhe pika e katërt, e fundit, projektvendimi për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për Qarkun Lezhë, zonjës Elda Hoti.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

**Z.Y.Merkaj:** Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar në datën 10.09.2021 Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend për shkak të dorëheqjes së zonjës Najada Fatos Çomo, deputete e zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë propozuar nga subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë. Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, Komisioni Rregullator me vendimin nr.21, datë 13.07.2021 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluar në datën 25 prill 2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr.409, datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, ka fituar 18 mandate. Rezulton se lista shumëemërore e Partisë Socialiste në zonën zgjedhore Qarku Tiranë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara të nenit 67, të Kodit Zgjedhor duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Duke qenë se, dorëheqja e zonjës Najada Çomo ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar, zëvendësimi i vakancës do të bëhet nëpërmjet përcaktimit të nenit 163, pika 7 dhe 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr.409, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Neni 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor parashikon se mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të Këshillit të Bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës në kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listën e gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht ndaj renditjes në listë, emrat e tjerë të kësaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Në

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

këtë rast plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës sipas listës së rirenditur të kandidatëve do të bëhet me kandidatin e radhës së gjinisë së nënpërfaqësuar. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i takon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 20, zonja Mimi Pjetër Kodheli, referuar nenit 11, të ligjit nr.138, të vitit 2015 dhe deklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhëna në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumëemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvend, të cilit i kalon mandati i deputetit për vendin e mbetur vakant. Përsa më sipër kandidati për deputet ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, me numër unik 1899. Pas verifikimeve të kryera të formularit të vetëdeklarimit sipas pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet në zonën zgjedhore në Qarkun Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, zonja Mimi Pjetër Kodheli nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë. Përsa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit i zonjës Najada Çomo, i përket kandidatit vijues në listën shumëemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 20, zonja Mimi Pjetër Kodheli. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe materialet përkatëse. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja “i” dhe “n” dhe pika 2 si dhe nenit 163, pika 7, nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin dhe integritetin të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, zonjës Mimi Pjetër Kodheli.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare.

**Vendimi nr.440**

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*

***RENDI I DITËS***

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë,  
kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku  
Durrës, zoti Denis Mehmet Deliu ”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve     **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:     **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**
- **Parti Politike:**

*Z.I.Celibashi:* Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

*Z.Y.Merkaj:* Në datën 10.09.2021, Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes së zotit Lifter Haki Koka, deputet i zonës zgjedhore Qarku Durrës, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Komisioni Rregullator me vendim nr.21, datë 13.07.2021 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, ku dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.408, datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve sipas subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021. Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Durrës, ka fituar 8 mandate. Rezulton se lista shumëemërore e

***Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku***

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

Partisë Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Durrës, i plotëson kriteret e përcaktuara të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimit të nenit 163, pika 7 dhe 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr.408 datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas këtij vendimi rezulton se kandidati, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 9, i kësaj liste shumëemërore, zoti Denis Mehmet Deliu. Referuar nenit 11 të ligjit nr.138, të vitit 2015, vetëdeklarimet dhe verifikimi i kushteve të dhëna në përputhje me këtë ligj bëhet për çdo kandidat, të listës shumëemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvend, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit. Përsa më sipër, kandidati për deputet ka plotësuar, depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1673. Nga verifikimi i formularit, rezulton se nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138, të vitit 2015. Pas verifikimit të formularit të vetëdeklarimit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për deputet, për zonën zgjedhore Qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, zotit Denis Mehmet Deliu, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij, në funksionin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit zoti Lefter Haki Koka i kalon kandidatit vijues në listën shumëemërore të Partisë Socialiste, për zonën zgjedhore Qarku Durrës, i renditur me numër rendor 9, zotit Denis Mehmet Deliu. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja “i” dhe “n” dhe pika 2 si dhe nenit 163, pika 7, dhe nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zonën zgjedhore Qarku Durrës, zotit Denis Mehmet Deliu.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në fletoren zyrtare gjithashtu.

**Vendimi nr.441**

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*

10.09.2021

Ora 13:15

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zonja Mirela Llambro Pitushi”.**

**PJESËMARRJA :**

**• KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**

**• Parti Politike:**

**Z.I.Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z.Y.Merkaj:** Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar në datën 10.09.2021 Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes së zotit Gramoz Kaso Ruçi, deputet i zonës zgjedhore qarku Fier, propozuar nga Partia Socialiste. Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar me vendimin nr. 417, datë 23.06.2021 shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë fituar mandat sipas numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore të Qarkut Fier. Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste në zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka fituar 9 mandate. Rezulton se lista shumëemërore e Partisë Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Fier i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vendit vakant do të bëhet sipas përcaktimit të nenit 163 pika 7 dhe 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor, Si dhe vendimit nr. 417, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 10, zonja Mirela Llambro Pitushi. Referuar nenit 11 të ligjit nr.138, të vitit 2015, kandidati për deputet ka depozituar dhe plotësuar formularët e deklaramit, depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 1824. Pas verifikimeve të kryera, sipas kreut V, pikës 2, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e deputetit, për zonën zgjedhore Qarku Fier. Për sa më sipër mandati i ndërprerë i deputetit, zotit Gramoz Kaso Ruçi i përket kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore Qarku Fier, i renditur me numër rendor 10, zonja Mirela Llambro Pitushi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe “n” dhe pika 2, si dhe nenit 163 pika 7, neni 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr. 138 i vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.17 të vitit 2016, vendos: Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për zonën zgjedhore të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

Qarkut Fier, zonjës Mirela Llambro Pitushi. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në në fletoren zyrtare si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

**Vendimi nr.442**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

10.09.2021

Ora 13:18

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmërore të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, Qarku Lezhë, zonja Elda Artan Hoti”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z.Illirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:**

**Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**

- **Parti Politike:**

**Z.I.Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

**Z.Y.Merkaj:** Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës për Kuvend, për shkak të dorëheqjes së zotit Mark Pjetër Marku, deputet i zonës zgjedhore qarku Lezhë, propozuar nga koalicioni PD-AN. Koalicioni PD-AN është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 414, datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore. Ka përcaktuar kandidatët fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore të Qarkut Lezhë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Sipas këtij vendimi, koalicioni PD-AN

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë ka fituar 4 mandate. Rezulton se nga lista shumëemërore e koalicionit, në zgjedhjet në zonën zgjedhore Qarku Lezhë i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vendit vakant do të bëhet sipas përcaktimit të nenit 163 pika 4 dhe 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 414, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 5, zonja Elda Artan Hoti. Referuar nenit 11 të ligjit nr.138, të vitit 2015, vetëdeklarimet dhe verifikimi i të dhënave në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumëemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvend, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin e mbetur vakant. Për sa më sipër kandidatja për deputete ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit, me numër rendor unik 2513. Pas verifikimeve të kryera të formularit të deklarimit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit, zotit Mark Pjetër Marku i përket kandidatit vijues në listën shumëemërore të koalicionit PD-AN, në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 5, zonjës Elda Artan Hoti. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe “n” dhe pika 2, si dhe nenit 163 pika 7, neni 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr. 138 i vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.17 të vitit 2016, vendos: Dhënien e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.09.2021*

mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kandidatit të radhës në listën shumëemërore të koalicionit PD-AN në zonën zgjedhore të Qarkut Lezhë, zonjës Elda Artan Hoti. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së. Faleminderit, seanca mbyllet!

**Vendimi nr.443**